



Vendimi i datës 27/04/2020, nga Ministria e Financave dhe Transfereve për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve të reja me COVID - 19

Me qëllim të implementimit të Vendimeve Nr. 01/07 dhe 01/09 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për “marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me COVID 19”, Ministria e Financave dhe Transfereve ka marrur vendim për zgjatjen e afatit për pagesën e tatimeve nga 30 Prill 2020, deri më 30 Qershor 2020, si në vijim:

1. Pasqyra tremujore e tatimit dhe kontributeve për bizneset e mëdha individuale (IL);
2. Pasqyra tremujore e tatimit dhe kontributeve për bizneset e vogla individuale (IS);
3. Pasqyra tremujore e pagesës paradhënie për Korporatat e Mëdha (QL); dhe
4. Pasqyra tremujore e pagesës paradhënie për Korporatat e Vogla.

Afati për deklarimin e tatimeve të lartpërmendura mbetet deri me datën 30 prill 2020 dhe bëhet në pajtim me legjislacionin tatimor në fuqi. Ky Vendim është i aplikueshëm për të gjithë tatimpaguesit të cilët në bazë të legjislacionit tatimor janë të obliguar të deklarojnë dhe paguajnë tatimet e lart përmendura.

Tatimpaguesit të cilët janë në vështirësi financiare për shkak të pandemisë, mundën që të bëjnë kërkesë për marrëveshje të pagesës me këste, dhe bazuar në dëshmitë e prezantuar, Administrata Tatimore e Kosovës mund të mundësojë formën e tillë të pagesës për këto lloje të tatimit duke i rezervuar vetes të drejtën që pas përfundimit të masave në fuqi edhe të bëjë verifikimin e secilit rast.

Për të gjitha llojet e tjera të tatimeve afati për deklarim dhe pagesë përfundon me datën 30 prill 2020 sipas Vendimit Nr. 26/2020 të datës 19.03.2020, të Ministrit të Financave dhe Transfereve.

Ky dokument bëhet vetëm për qëllime informative. Nuk përbën këshillë ligjore dhe/ose angazhim të çdo lloj natyre. Për çdo sqarim ju lutem kontaktoni:

tax_legal-alko@deloittece.com



Decision dated 27/04/2020 from the Ministry of Finance and Transfers, for undertaking additional measures after the confirmation of additional cases with COVID-19

With the intention to implement Decisions No.01/07 and 01/09 of the Government of Republic of Kosova “for undertaking additional measures after confirmation of positive cases of COVID – 19”, has rendered a decision for the extension of the deadline regarding payment of taxes, from 30 April 2020, until the 30 th of June 2020, as follows:

1. Quarterly statements of taxes and contributions for large individual businesses;
2. Quarterly statements of taxes and contributions for small individual businesses;
3. Quarterly statements of down payments for large corporations; and
4. Quarterly statements of down payments for small corporations;

The deadline for abovementioned statements will remain 30 th of April 2020 and shall be made in accordance with the applicable tax legislation. This Decision is applicable for all taxpayers which in accordance with the tax legislation are obligated to declare and pay the above mentioned taxes.

Taxpayers in financial difficulties due to the pandemic, may file a request for an agreement to pay taxes through installments, based on the evidence presented, the Tax Administration of Kosova may allow this form of payment, with the discretion to verify such cases after the current measures for COVID-19 are lifted by the authorities.

For any other types of taxes, the deadline for the statements and payments is 30 th of April 2020 as per Decision No.26/2020 dated 19.03.2020, of the Ministry of Finances and Transfers.

This document is delivered for informative purposes only. It does not constitute legal/tax counsel and/or commitments of any nature. For any further clarification please contact: **tax_legal-alko@deloittece.com**